

UDHËZIM
Nr. 1, datë 25.3.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR
TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM DHE TË PËRHERSHËM TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 44, pika 6 dhe 46, pika 4, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”,

UDHËZOJ:

KREU I
TRANSFERIMI I PËRKOHSHËM

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 1
Rastet e transferimit të përkohshëm

1. Transferimi i përkohshëm për nevoja të punës kryhet në një zyrë përmbarimore që:
 - a) ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm, që konstatohet kur përmbaruesi gjyqësor shtetëror që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion, situatë e cila cenon funksionimin normal të zyrës përmbarimore;
 - b) sipas vlerësimit të drejtorit të përgjithshëm, një zyrë përmbarimore ka ngarkesë pune më të lartë se ngarkesa në të njëjtën periudhë të një viti më parë, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj për shkak të numrit të lartë të çështjeve në ekzekutim, kompleksitetit të tyre, si dhe numrit të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë në atë zyrë;
 - c) nuk ka asnjë përmbarues gjyqësor shtetëror që mund të kryejë ekzekutimin e dosjeve përmbarimore të caktuara për shkak të konfliktit të interesit, ose;
 - ç) nuk mund të kryejë ekzekutimin e dosjeve përmbarimore të caktuara për shkak të rrethanave objektive që lidhen me zyrën përmbarimore apo me përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë.
2. Transferimi i përkohshëm në interes të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror kryhet:
 - a) kur përvoja e një përmbaruesi shtetëror gjyqësor i shërben përgatitjes sa më të mirë të kandidatëve fitues, në periudhë prove në një zyrë tjetër përmbarimore kur vlerësohet se, përvoja në detyrë e përmbaruesve shtetërorë në atë zyrë është e pamjaftueshme për të qenë mbikëqyrës të kandidatëve fitues;
 - b) për raste të tjera, për të cilat drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit vlerëson se transferimi i përkohshëm është në interes të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Neni 2
Fillimi i procedurës për transferimin e përkohshëm

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit fillon procedurën e transferimit të përkohshëm, kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të zyrës përmbarimore. Në kërkesë jepet informacion mbi:
 - a) të paktën një nga rastet e përcaktuara në nenin 1, të këtij urdhri;
 - b) masat e marra për të përmbushur nevojat e zyrës së përmbarimit duke shmangur transferimin e përkohshëm;
 - c) periudhën e përafërt të transferimit të përkohshëm;

ç) çdo të dhënë apo informacion tjetër që i shërben vlerësimit të nevojës për transferim të përkohshëm.

2. Drejtori i përgjithshëm shqyrton kërkesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës sipas pikës 1 të këtij neni, për:

- a) fillimin e procedurës për transferimin e përkohshëm, ose;
- b) mosfillimin e procedurës për transferimin e përkohshëm.

3. Në caktimin e periudhës së transferimit të përkohshëm, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit mban parasysh mbarëvajtjen e shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror në tërësi, si dhe zyrat përmbarrimore ndërmjet të cilave ndodh transferimi.

Neni 3

Kriteret për transferimin e përkohshëm

Në çdo rast, nuk mund të transferohet përkohësisht përmbarruesi gjyqësor shtetëror i cili:

- a) nuk ka marrë emërimin përfundimtar nga ministri i Drejtësisë;
- b) është kryetar i një zyre përmbarrimore;
- c) është transferuar 2 herë brenda një viti;
- ç) ka konflikt interesi, kur transferimi i përkohshëm kryhet për ekzekutimin e dosjeve përmbarrimore të caktuara;
- d) është vlerësuar në nivelin “Mjaftueshëm” ose “I pamjaftueshëm” në vlerësimin e fundit;
- dh) është i pezulluar;
- e) është duke u proceduar dhe Këshilli i Përmbarrimit nuk ka marrë ende vendim sipas neneve 78 ose 82, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”;
- ë) ka masë disiplinore në fuqi.

Neni 4

Zgjedhja e zyrës përmbarrimore prej së cilës transferohet përmbarruesi

1. Transferimi i përkohshëm, si rregull, bëhet nëpërmjet transferimit të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë që janë të emëruar në zyrë përmbarrimore me ngarkesë më të ulët. Për përcaktimin e ngarkesës së punës, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit vlerëson të dhënat e disponueshme mbi numrin e çështjeve në ekzekutim, kompleksitetin e tyre, si dhe numrit të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë në secilën zyrë përmbarrimore në 2 (dy) vitet e fundit.

2. Zyra përmbarrimore prej së cilës do të transferohet përmbarruesi gjyqësor shtetëror zgjidhet nga radhët e zyrave më të afërta me zyrën përmbarrimore në të cilën do të transferohet përkohësisht përmbarruesi gjyqësor shtetëror.

3. Transferimi i përkohshëm nuk kryhet nëse efekti negativ që shkakton në funksionimin e zyrës përmbarrimore prej së cilës do të transferohet përmbarruesi gjyqësor shtetëror, është më i madh se dobia që ai pritët të sjellë në zyrën përmbarrimore shtetërore në të cilën do të transferohet. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit kryen vlerësimin e efekteve të transferimit pasi merr, në çdo rast dhe paraprakisht, mendimin e kryetarëve të zyrave përmbarrimore.

4. Kryetarët e zyrave përmbarrimore japin mendimin brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Mendimi i Kryetarëve nuk është detyrues.

5. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit kryen një verifikim paraprak të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje nga ana e përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë, në bazë të dokumentacionit të zotëruar prej Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit. Pas verifikimit paraprak, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit përgatit listën e zyrave përmbarrimore, përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë të të cilave plotësojnë kriteret.

6. Në përfundim të procesit të përcaktuar nga pikat 1 deri 5 të këtij neni, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit cakton zyrën përmbarrimore prej së cilës do të transferohet përmbarruesi gjyqësor shtetëror brenda 7 ditëve.

Neni 5

Shpallja e njoftimit për transferim të përkohshëm

1. Pasi caktohet zyra përmbarimore prej së cilës do të transferohet përmbaruesi gjyqësor shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dërgon në adresën elektronike të përmbaruesve gjyqësor që mund të transferohen përkohësisht, si dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit njoftimin mbi nevojën për transferim të përkohshëm.

2. Njoftimi dërgohet jo vonë se 2 ditë nga evidentimi i zyrës përmbarimore.

3. Njoftimi përmban të paktën:

a) përcaktimin e rastit sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje;
b) zyrën përmbarimore ku do të transferohet përmbaruesi gjyqësor shtetëror;
c) periudhën e përafërt të transferimit;
ç) afatin brenda të cilit përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të paraqesë pëlqimin me shkrim për transferim, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i shkurtër se 7 ditë kalendarike nga publikimi i njoftimit;

d) dokumentacionin shoqërues që shoqëron pëlqimin dhe që nuk mund të administrohet kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;

dh) adresën postare ose elektronike në të cilën duhet të paraqitet pëlqimi.

Neni 6

Transferimi i përkohshëm në bazë të pëlqimit

1. Transferimi i përkohshëm, si rregull, kryhet me pëlqimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror që transferohet.

2. Në rastin kur asnjë përmbarues gjyqësor shtetëror nuk paraqet pëlqimin, transferimi i përkohshëm bëhet edhe pa pëlqim.

Seksioni 2

Transferimi i përkohshëm me pëlqim

Neni 7

Kërkimi i pëlqimit nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror

1. Nëse nevoja e një zyre përmbarimore, në të cilën është i transferuar përkohësisht me pëlqim një përmbarues gjyqësor shtetëror, mund të përmbushet sërish përmes transferimit të përkohshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit fton fillimisht, për të paraqitur pëlqimin, përmbaruesin që është i transferuar. Paraqitja e pëlqimit nuk kërkohet kur nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në këtë rregullore ose nëse transferimi i tij cenon funksionimin normal të zyrës përmbarimore, në të cilën është i emëruar.

2. Në çdo rast tjetër, paraqitja e pëlqimit iu kërkohet të gjithë përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 3, të kësaj rregulloreje.

3. Pëlqimi paraqitet me shkrim dhe dërgohet përmes shërbimit postar ose në rrugë elektronike, brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit.

Neni 8

Verifikimi paraprak

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit administron pëlqimin dhe dokumentacionin shoqërues dhe brenda 2 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur pëlqimi dhe dokumentacioni shoqërues përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, njofton kandidatin me shkrim mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kriterëve;

b) kur pëlqimi dhe dokumentacioni shoqërues nuk përmban të gjithë dokumentacionin e

nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, njofton përmbaruesin për plotësimin e të metave.

Neni 9

Verifikimi i plotësimit të kriterëve

1. Brenda 2 ditëve nga njoftimi mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit ose përfundimi i afatit për plotësimin e të metave, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit verifikon nëse përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë plotësojnë kriteret në nenin 3, të kësaj rregulloreje.

2. Verifikimi kryhet në bazë të dokumentacionit:

- a) që zotëron Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarimit;
- b) të vendosur në dispozicion nga çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
- c) të paraqitur nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror.

3. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj.

4. Në rast se në përfundim të verifikimit mbi plotësimin e kriterëve, ka më shumë se një përmbarues gjyqësor shtetëror që paraqet pëlqimin për transferim të përkohshëm, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit zgjedh përmbaruesin gjyqësor shtetëror që do të transferohet, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a) përvoja profesionale;
- b) dy vlerësimet e fundit;
- c) ngarkesa e punës së secilit përmbarues, dhe;
- ç) dosjet konkrete përmbarimore që janë duke ekzekutuar.

5. Në urdhrin për transferimin e përkohshëm, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit arsyeton zgjedhjen e tij.

Neni 10

Ankimi i urdhrin të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror që ka paraqitur pëlqimin dhe që nuk është zgjedhur për t'u transferuar përkohësisht ka të drejtë të ankohet kundër urdhrin të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

Seksioni 3

Transferimi i përkohshëm pa pëlqim

Neni 11

Fillimi i procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim

Kur asnjë përmbarues gjyqësor shtetëror nuk paraqet pëlqimin për transferim të përkohshëm drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit urdhëron nisjen e procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim.

Neni 12

Zgjedhja e përmbaruesit që transferohet përkohësisht pa pëlqim

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror që do të transferohet përkohësisht pa pëlqim zgjidhet nga radhët e përmbaruesve të zyrës përmbarimore të zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

2. Si rregull, përmbaruesi gjyqësor shtetëror që do të transferohet përkohësisht zgjidhet si më

poshtë:

- a) përmbaruesi duhet të ketë përvojën më të pakët si përmbarues gjyqësor shtetëror;
 - b) nëse ka disa përmbarues që kanë të njëjtën përvojë si përmbarues gjyqësor shtetëror, zgjidhet përmbaruesi që ka përvojë më të pakët profesionale si jurist;
 - c) nëse ka disa përmbarues që kanë të njëjtën përvojë si jurist, zgjidhet përmbaruesi më i ri në moshë.
3. Në rastet kur nevojat e punës dhe interesat e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror nuk mund të përmbushen nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror i zgjedhur sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit, pasi kryen vlerësimin sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje, vendos transferimin e një përmbaruesi gjyqësor shtetëror tjetër të zgjedhur nga lista e zyrave përmbarimore me ngarkesë më të ulët.
4. Pikat 4 dhe 5, të nenit 9, të kësaj rregulloreje zbatohen edhe për transferimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror pa pëlqim.
5. Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit i njoftohet menjëherë përmbaruesit gjyqësor shtetëror që do të transferohet përkohësisht pa pëlqim.

Neni 13

Refuzimi

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror i zgjedhur sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje mund të refuzojë me shkrim transferimin brenda 5 ditëve nga njoftimi i urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit.
2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit shqyrton refuzimin brenda 7 ditëve.
3. Kur drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit konstaton se gjendja shëndetësore e përmbaruesit gjyqësor shtetëror e bën transferimin të pamundur, zgjedh një përmbarues tjetër duke ndjekur procedurën e parashikuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje.
4. Në çdo rast tjetër, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit nuk e pranon refuzimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror.
5. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtë të ankohet kundër urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit për mospranimin e refuzimit, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

KREU II

TRANSFERIMI I PËRHERSHËM

Seksioni 1

Transferimi i përhershëm për shmangien e konflikteve të vazhdueshme të interesit

Neni 14

Subjekti që fillon procedurën

Procedura për transferimin e përhershëm në rastet e shmangies së konflikteve të vazhdueshme të interesit fillon:

- a) me kërkesë të vetë përmbaruesit gjyqësor shtetëror;
- b) me kërkesë të kryetarit të zyrës përmbarimore ku ushtron funksionin përmbaruesi gjyqësor shtetëror i cili ndodhet në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit, ose;
- c) kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

Neni 15

Kërkesa për transferim të përhershëm

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror paraqet në kërkesën për transferim të përhershëm:
 - a) interesat privatë të cilat bëhen shkak për konflikt të vazhdueshëm interesi;

- b) rrethanat faktike dhe ligjore që shkaktojnë konfliktin e vazhdueshëm të interesave;
 - c) masat e marra nga përmbauesi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit, nëse ka ndërmarrë masa të tilla;
 - ç) argumentet pse transferimi i përhershëm është e vetmja mënyrë për të shmangur konfliktin e vazhdueshëm të interesit.
2. Kryetari i zyrës përmbaimore paraqet në kërkesën për transferim të përhershëm:
- a) të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas pikës 1, të këtij neni, që disponohen prej tyre;
 - b) qëndrimin e përmbauesit gjyqësor shtetëror, në lidhje me vlerësimin e tyre, për ekzistencën e konfliktit të vazhdueshëm të interesit.

Neni 16

Shqyrtimi i kërkesës nga drejtori i përgjithshëm i Përmbaimit

Drejtori i përgjithshëm shqyrton kërkesën dhe merr vendim brenda 10 ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesave sipas nenit 15, të kësaj rregulloreje, për:

- a) propozimin e transferimit të përhershëm nëse ka dyshime të arsyeshme se ekziston konflikti i vazhdueshëm i interesit, duke propozuar edhe zyrën përmbaimore ku do të transferohet përmbauesi ose;
- b) të mos propozuar transferimin e përhershëm kur:
 - i. provat dhe argumentet janë haptazi të pamjaftueshme për të provuar ekzistencën e konfliktit të vazhdueshëm të konfliktit të interesit;
 - ii. çështja ka qenë objekt i një kërkesë të mëparshme që është mbyllur ose për të cilën ministri i Drejtësisë është shprehur, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja.

Neni 17

Shqyrtimi i propozimit nga ministri i Drejtësisë

Ministri i Drejtësisë shqyrton propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Përmbaimit dhe vendos, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së propozimit, për:

- a) njoftimin e përmbauesit gjyqësor shtetëror për transferimin e përhershëm të tij, si dhe zyrën përmbaimore ku ai do të transferohet;
- b) refuzimin e propozimit për transferimin e përhershëm, kur provat dhe argumentet janë të pamjaftueshme për të provuar ekzistencën e konfliktit të vazhdueshëm të konfliktit të interesit.

Neni 18

Refuzimi i transferimit të përhershëm

1. Në rast se përmbauesi gjyqësor shtetëror, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, refuzon transferimin e përhershëm, paraqet edhe dokumentacionin që provon shkakun e refuzimit.
2. Kur përmbauesi gjyqësor refuzon transferimin në përputhje me rastet e parashikuara nga neni 45, pika 2, e ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbaimitor Gjyqësor Shtetëror”, ministri i Drejtësisë i kërkon drejtorit të përgjithshëm të Përmbaimit dërgimin e propozimeve për zyra të tjera përmbaimit ku mund të transferohet përmbauesi.
3. Kur përmbauesi gjyqësor nuk refuzon transferimin e përhershëm ose ka kaluar afati për të paraqitur refuzimin, ministri i Drejtësisë urdhëron transferimin e përhershëm të përmbauesit gjyqësor shtetëror.

Seksioni 2

Transferimi i përhershëm për shkak të mbylljes ose ristrukturimit të zyrës përmbaimore

Neni 19

Rastet e transferimit të përhershëm

1. Transferimi i përhershëm për shkak të mbylljes ose ristrukturimit të zyrës përmbarimore kryhet kur:

- a) shkurtohen pozicione;
- b) ristrukturohen pozicione;
- c) ndryshojnë kriteret për pozicionin.

2. Në këto raste, përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të sistemohet në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

Neni 20

Njoftimi mbi mbylljen apo ristrukturimin e zyrës përmbarimore

1. Përmbaruesit e zyrës përmbarimore të mbyllur apo të ristrukturuar njoftohen individualisht nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit për fillimin e procedurës së transferimit, për shkak të ristrukturimit apo mbylljes të zyrës përmbarimore, në momentin e miratimit të aktit të mbylljes apo ristrukturimit së institucionit.

2. Efektet financiare për përmbaruesin që do të transferohet apo do t'i përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit.

Neni 21

Komisioni i ristrukturimit

1. Në rastet e ristrukturimit apo mbylljes, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo përmbaruesi gjyqësor shtetëror në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e tij në një pozicion të lirë.

2. Komisioni ngrihet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit dhe përbëhet nga jo më pak 3 anëtarë.

3. Komisioni, në propozimin e tij për transferimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të zyrës përmbarimore, mbështetet në:

- a) kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit;
- b) përvojën profesionale të përmbaruesit gjyqësor shtetëror;
- c) dy vlerësimet e fundit.

4. Komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e ristrukturimit, i propozon me shkrim drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit transferimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

Neni 22

Shqyrtimi i propozimit nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit

Drejtori i përgjithshëm shqyrton propozimin dhe merr vendim brenda 7 ditëve, nga data e paraqitjes së tij, për:

- a) propozimin e transferimit të përhershëm, ose;
- b) të mos propozuar transferimin e përhershëm dhe kthimin për rishqyrtimin e transferimit nga ana e Komisionit kur, haptazi rezulton se nuk janë respektuar parashikimet e pikës 3, të nenit 21 të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Shqyrtimi i propozimit nga ministri i Drejtësisë

Ministri i Drejtësisë shqyrton propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit dhe vendos brenda 15 ditëve, nga data e paraqitjes së propozimit, për:

- a) njoftimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për transferimin e përhershëm të tij, si dhe zyrën përmbarimore ku ai do të transferohet;

b) refuzimin e propozimit për transferimin e përhershëm kur rezulton se nuk janë respektuar parashikimet e pikës 3, të nenit 21 të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Refuzimi i transferimit të përhershëm

Parashikimet e nenit 18 të kësaj rregulloreje, zbatohen edhe në rastet e transferimit të përhershëm për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të zyrës përmbarimore.

Neni 25

Regjistri i transferimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit krijon dhe mban një regjistër të posaçëm i cili përmban informacion mbi përmbaruesit gjyqësorë shtetërore të transferuar sipas kësaj rregulloreje dhe periudhën e transferimit.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja